



Pranuar / Received Punëpun / Pre-fido E lexuar / De-facto	14.06.2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKOPJESHK 3068/2021	Shtesa e Futeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
			1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.316/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.316/2021 të datës 29.04.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë Fshati "Turijakë", në Komunën e Malishevës, kundër organit të punësimit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.06.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.316/2021 e datës 29.04.2021 e parashtruar nga ankuesi**

### A r s y e t i m

Ankuesi sipas ndryshimit dhe plotësimit të akt emërimit të datës 11.02.2016 me numër të protokollit 494/2016 është i sistemuar në vendin e punës "Zyrtar i Lartë Ligjor" në Departamentin Ligjor, me datë 11.02.2016 me numër 487/2016 ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për rritje të koeficientit nga tetë (8) në nëntë (9), me arsyetim se është vlerësuar në tri vitet e fundit si shkëlqyeshëm. Ndërsa Sekretari i Përgjithshëm me datë 11.02.2016 merr vendimin me numër të protokollit 488/2016 me të cilin vendim i aprovohet kërkesa e ankuesit për ngritje të koeficientit nga tetë (8) në nëntë (9).

Pasi që ankuesi nuk e merr pagën sipas Vendimit me numër të protokollit 488/2016 të datës 11.02.2016, ankuesi me datë 18.03.2021 parashtron kërkesën tek Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit kërkesën për zbatim të pagesës sipas koeficientit nëntë (9). Ankuesi nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e tij të datës 18.03.2021 me datë 29.04.2021 parashtron ankesën me numër të protokollit 2073/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën më datë 05.05.2021 për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Këshilli

me datë 18.05.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/16.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritator administroj këto prova:* Ankesa e ankuesit e datës 29.04.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e datës 18.03.2021 për pagesë; Kërkesa e datës 11.02.2016 për ngritje të koeficientit; Vendimi i datës 11.02.2016 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 11.02.2016; Akt emërimi i datës 20.01.2012; Vendimi i datës 12.04.2013 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 26.04.2013 i Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimi i datës 10.06.2013 i Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimi i datës 17.06.2013 i Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimi i datës 14.06.2013 i Sekretarit të Përgjithshëm; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; 2019; 2018; 2017; 2016; Pasqyra me formularët e ndryshimeve për muajin nëntor 2020 e datës 11.11.2020 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit

*është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht në Akt emërimit e datës 20.01.2012 është konstatuar se ankuesi ka themeluar marrëdhënien e punë si "Udhëheqës i Divizionit për Zbatimin e Ligjit" në Departamentin Ligjor në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në kategorinë funksionale grada nëntë (9) dhe se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nxjerr vendimin me numër 1060/2013 me numër të protokollit 2362/2013 të datës 14.06.2013 me të cilin vendim me pëlqimin e ankuesit caktohet në vendin e punës "Zyrtar i Lartë Ligjorë" në Departamentin Ligjor me koeficient tetë (8).

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 11.02.2016 nxjerr vendimin me numër 146/2016 e me numër të protokollit 488/2016 me të cilin vendim i ngritët koeficienti i ankuesit nga tetë (8) në nëntë (9), për shkak të angazhimit të veçantë që do ti kryej punët shtesë në Departament Ligjor në Ministri të Kulturës, Rinisë dhe Sportit në cilësinë e "Zyrtarit Ligjor", mirëpo ankuesi që nga ngritja e koeficientit nuk është paguar me koeficient nëntë (9) dhe me datë 18.03.2021 ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit për zbatim të vendimit të datës 11.02.2016 me numër 146/2016, por pasi që nuk merr përgjigje me datë 29.04.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar nga Këshilli që ta obligoj organin e punësimit për zbatim të vendimit të lartë cekur si dhe ti bëhet kompensimi në mënyrë retroaktive nga data 11.02.2016 e nxjerrjes së vendimit me numër të protokollit 488/2016.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ngritja e koeficientit për nëpunës civil nga institucionet e administratës publike bëhet në koordinim me Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministria e Financave dhe miratuar nga Qeveria e Kosovës ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 7 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë i cili përcakton se: *"Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil"* dhe *"Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat"*, po ashtu me rastin e kthimit të



përgjigjes në ankesë nga organi i punësimit është cekur se: "Ju njoftojmë se Ministria e Financave nuk e ekzekuton asnjë vendim për rritje të koeficientit i cili nuk është zhvilluar përmes procedurave të rekrutimit, dhe kjo është arsyeja që nuk ka mundur të procedohet paga e tij sipas vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm".

Duke marr parasysh që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 11.02.2016 nxjerr vendimin me numër 146/2016 e me numër të protokollit 488/2016 me të cilin vendim i ngritët koeficienti i ankuesit nga tetë (8) në nëntë (9), Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar që ankuesi ka pasur të drejtë të parashtoj ankesën për mosrealizimin e pagesës sipas koeficientit nëntë (9), nw Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ashtu siç është përcaktuar saktë me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 50 ku përcaktohet se: 1. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave, përkatësisht nenin 8 ku përcaktohet se: 2. Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës, andaj Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i i ankuesit për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës, në mënyrë retroaktive nga data 11.02.2016, kur ankuesi e ka nënshkruar akt emërimit, është i pa bazuar sepse, ankuesi me datë 11.02.2016, ka nënshkruar Aktin e Emërimit me numër protokollit 494/2016, ndërsa është drejtuar me ankesë me datë 29.04.2021, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.316/2021.

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

*Procesmbajtëse*

Malsore GASHI BAJRAKTARI

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së